



Republika e Kosovës
Municipality of Istog
Republika Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Republic of Kosovo

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Istog shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Veterinarisë
Institucioni	Komuna Istog
Nr. i Referencës	RN00009131
Kodi	RPC0002879
Data e njoftimit	30.05.2022
Afati për aplikim	20.06.2022 - 30.06.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Kontroll Veterinar të objekteve, paisjeve dhe ushqimeve me prejardhje shtazore ;
2. Kontrollin e sigurisë së ushqimit me prejardhje shtazore ;
3. Ndalimin e thirjeve ilegale, shitjen e mishit për konsum public, inspektimin e fabrikave për pëpunimin e mishit;
4. Lëshimin e fletëtransporteve – qarkullimin e kafshëve të gjalla Brenda teritorit të Kosovës;
5. Në lëmin e veterinars – inspektimi i thertoreve, mishit dhe organeve të brenshme të kafshëve të dedikuara për konsum publik;
6. Damkosja dhe certifikimi i mishit për konsum, inspektimi i kushteve të prodhimit – përpunimit të produkteve me origjinë shtazore, objekteve hoteliere, tregjeve etj.;
7. Kryen punët dhe detyrat tjera në fushën profesionale specifike në përputhje me Ligjet dhe Rregulloret aktuale, si dhe kryen punët dhe detyrat të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrsi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, Fakulteti i Bujqësisë – Drejtimi i Veterinars, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;
- Kualifikime të posaqme formale: Certifikata të trajnimeve sa i përket kësaj pozite;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Ligji i procedurës së përgjithshme administrative;

Ligji, Rregulloret dhe Udhëzimet që i përkasin kësaj lëmie.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

